

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

Drejtuar :
Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:
Pallati i Kongreseve ,
Tirane Albania

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të vitit 2011 të përgatitura nga Partia e Gjelbër, në të cilat pasqyrohen fondet e krijuara dhe të përdorura nga kjo Parti per periudhen janar-dhjetor, 2011 si dhe gjendja pasurore e saj në këtë datë.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise” dhe Ligjin Nr. 9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” date 29.04.2004. Kjo pergjegjesi perfshin: dokumentacionin mbartes te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera, politiken kontabel te ndjekur per hartimin e pasqyrave financiare, zbatimin dhe organizimin e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen e pasqyrave financiare, qe mos permbajne anomali dhe gabime materiale. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur perfitohen ne vlera monetare dhe materiale dhe sherbime te konvertuara ne leke. Shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare , per fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate vitit 2011. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale. Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave financiare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve.

Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare me qellimin qe te hartoje procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opinionin ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te subjektit. Nje auditim perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdorura dhe

arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

Opinion

Duke marre Sipas opinionit tone, pasqyrat bashkalidhur , te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partia gjate Vitit 2011, ne perputhje me te drejten e perfitimit te fondit dhe kryerjes se shpenzimit, ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise dhe ligjin Nr.9228, date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Firma : STUDIO IRS FINANCË & AUDITIM SHPK
TIRANE

Titullari : Remzi SULO
Eksperti Kontabël i Rregjistruar



Datë : Tetor / 2012

Adresa: Rr. "Ymer Kurti", Qendra Tregëtare Olympia,
Tiranë -Albania

Tel: + 68 20 93 862
E-mail: suloremzi@yahoo.com

Ne Leke